

Thirrje për Kompanitë të Ueb Dizajni

Kërkojmë kompani të Ueb dizajnit për mirëmbajtjen dhe përditësimin e dy ueb faqeve të organizatës Syri i Vizionit-SiV (www.syriivizionit.org) dhe Grupit të Fëmijëve Respect Our Rights-ROR (www.ror-rks.net), që këto dy ueb faqe të jenë unike , të shpejta me funksione të plota dhe shumë të sigurta, si dhe lehtë për t'u mirëmbajtur.

Termet e Referencës

Hyrje

Syri i Vizionit (SiV) është regjistruar zyrtarisht si organizatë joqeveritare lokale në shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë edhe më herët, që nga viti 1999, si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës. Që nga fillimi, motoja e organizatës ka qenë “Mendo globalisht, vepro lokalisht”, të cilës organizata i ka qëndruar besnike. Misioni i organizatës është “Zhvillimi i komunitetit të njerëzve, grupeve joformale, organizatave, rrjeteve, institucioneve dhe donatorëve përmes avokimit, shkëmbimit të informacionit dhe ndërgjegjësimit” dhe SiV përmes veprimit të saj dëshmon se është një organizatë që kryen veprime lokale bazuar në praktikat më të mira.

II. Informata të përgjithshme

Syri i Vizionit (SiV) është duke zbatuar projektin “ **Detyrimi ynë për të ardhmen – Mbrojtja e Fëmijëve dhe Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve** në partneritet me Save the Children Kosova/o (SCiK), mbështetur financiarisht nga Sida. Ky projekt ka për qëllim rritjen e ekspertizës dhe kapaciteteve të OSHC-ve, për të avokuar për të drejtat e fëmijëve dhe për t'i mbajtur udhëheqësit përgjegjës që të ofrojnë qasje të barabartë në sisteme cilësore të mbrojtjes së fëmijëve dhe mekanizma të të drejtave të tyre, si dhe të krijohen kushte dhe mundësi që fëmijët të organizohen dhe të shprehin çështjet e tyre në interesin e përbashkët.

Në kuadër të programit tematik në fushën e mbrojtjes dhe qeverisjes me të drejtat e fëmijëve, po punohet në parandalimin e dhunës dhe ndëshkimit trupor ndaj fëmijëve në çdo ambient, krijimin e mekanizmave apo instrumenteve miqësore dhe të besueshme ndaj fëmijëve për të raportuar rastet e dhunës në shkollë. Fuqizimin e grupeve të fëmijëve përmes Asambleve Komunale të Fëmijëve-AKF dhe Grupin Monitorues Respect Our Rights-ROR, në fushën e të drejtave dhe përfshirjen aktive të tyre në vendimmarrje në nivel lokal dhe nacional.

Pjesë e rëndësishme e programit është ngritja e kapaciteteve, fuqizimi dhe zhvillimi i grupit të fëmijëve ROR dhe nga Asambletë komunale të fëmijëve në monitorimin e zbatimit të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve në Kosovë dhe mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës duke i bërë pjesë të proceseve dhe politikave vendimmarrëse .

III. Objektiva

Syri i Vizionit kërkon të angazhojë një kompani profesionale të Ueb Dizajnit (zhvillimin, dizajnimin dhe mirëmbajtjen e ueb faqeve) për ridizajnimin dhe mirëmbajtjen e ueb faqes së organizatës Syri i Vizionit SiV, dhe ndërtimin e ueb faqes për grupin e fëmijëve “Respectt Our Rights – ROR”, si dy platforma për të paraqitur punën që bëhet, duke përfshi këtu qasje dhe komunikim më të shpejtë dhe më të lehtë me grupet e interesit që SiV dhe ROR përfaqëson apo punon. Duke përfshi lajme dhe informacione nga aktivitetet ditore, mujore e vjetore, publikim të raporteve, dhe materialeve tjera promovuese, fotove, videove, blogjeve si dhe mundësi të realizimit të hulumtimeve të ndryshme online.

IV. Kualifikimi i nevojshëm:

- Certifikimi në Teknologjitë e Internetit ose Programimin e Internetit dhe të paktën tre vjet përvojë pune në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e faqeve të internetit;
- Përvojë e vërtetuar në dizajnimin e faqeve të internetit në mënyrë kreative me cilësi të lartë në mënyrë kohore, siç dëshmon një portofolio i faqeve të zhvilluara;
- Historiku i punës së mëparshme;
- Kompania duhet të paraqes gjithashtu ofertën teknike që do të përfshijë vizionin e përgjithshëm për mjete softuerike për menaxhimin e faqes së internetit;
- Statusi ligjor i biznesit përfshin një kopje të regjistrimit dhe licensimit të kompanisë;

V. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

Kompania e angazhuar pritet të:

- Të prezantojë një koncept fillestar për ridizanimin e ueb faqes së organizatës SiV, si dhe konceptin e ndërtimit të ueb faqes së për grupin ROR;
- Ridizajnimi dhe zhvillimi i ueb faqeve të bëhet në bashkëpunim me stafin e SiV dhe fëmijët e grupit ROR, që të kenë një dizajn të pastër, profesional, dhe modern;
- Menaxhimi dhe përditësimi i informatave brenda ueb faqes së organizatës SiV duhet të kaloj nga CMS në Wordpress, po ashtu për grupin e fëmijëve;

- Ueb faqet duhet të jetë kompatibël/miqësore me të gjithë shfletuesit kryesorë të internetit duke përfshirë Internet Explorer, Google Chrome, Firefox, Netscape, Opera, Maxthon dhe shfletuesit e bazuar në Macintosh;
- Udhëzime mbi mirëmbajtjen dhe administrimin e portalit për administratorët e faqes relevante në internet;
- Dizajn i përshtatshëm për desktop, laptop dhe celular (smart phone), me kohë ngarkimi të mirë dhe të shpejtë;
- Karakteristika të avancuara si header video, sliderë dhe imazheve në galeri;
- Lidhje me mediatë social dhe ndarja në media sociale;
- Gjenerimi i raporteve e vizitorëve të ueb faqeve në baza mujore e vjetore, ku do të ketë qasje edhe stafi i organizatës SiV dhe grupi RoR.
- Ndhima dhe përkrahje e vazhdueshme gjatë gjithë vitit pa kompensim shtesë;

VI. Angazhimi i Ekspertit/es:

Kompania do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me Syri i Vizionit- nën koordinim të Menaxherit të Financave dhe Administratës. Në këtë kontratë do të përcaktohen në mënyrë specifike pikat të cilat nuk janë të përfshira në këtë dokument. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit mars dhe prill në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyrat	Kohëzgjatja
Familjarizimi i kompanisë me dy ueb faqet	2 ditë
Mbajtja e takimit me stafin e SiV dhe përfaqësuesve të ROR	1 ditë
Përgatitja e konceptit fillestar të ueb faqeve (dizajni, zhvillimi dhe programi i ueb sajteve)	20 ditë
Finalizimi i ueb faqeve pas komenteve dhe sugjerimeve nga SiV dhe ROR e SCiK	10 ditë
Lansimi dhe mirëmbajtja e ueb faqeve: www.syriivizionit.org dhe www.ror-rks-net	12 muaj

VII. Kushtet e Pagesës: Pagesa e kompanisë do të bëhet sipas kontratës përkatëse për kryerjen e shërbimeve dhe pranimit të faturave për dy ueb faqet. Pagesa do të realizohet përmes transaksionit bankar në valutën Euro. Pagesa do të bëhet pas përfundimit me sukses të të gjitha obligimeve të përcaktuara me ToR.

VIII. Dokumentet e kërkuara dhe procedura për aplikim:

1. Kopja e certifikatës së regjistrimit dhe licencimit si kompani profesionale në ueb dizajn;
2. Metodologjinë e punës në përditësimin dhe mirëmbajtjen e ueb faqeve, duke përfshirë planifikimin e procesit të ridizajnit, përditësimin, ndërtimit dhe lansimin;
3. Dëshmi të përvojës në zhvillimin, dizajnimin dhe mirëmbajtjen e ueb faqeve për organizata dhe grupe joformale apo të ngjashme (ofrohet katalog i mostrave në USB ose e shtypur apo liqet referuese);
4. Planin tentativë të punës duke ju referuar kriterëve të angazhimit kohor sipas pikës VI;
5. Biografia - CV e personelit që do të jenë të angazhuar;
6. Propozimi financiar*

**Oferta financiare duhet të jetë e hollësishme për secilën punë që do të realizohet, duke përfshirë, përditësimin, zhvillimin, lansimin dhe mirëmbajtjen e ueb faqeve*

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: office@syriivizionit.org ose naser.lajqi@syriivizionit.org me subjektin: Aplikacioni për Ridizajnimin, Ndërtimin dhe Mirëmbajtjen e Uebfaqeve të SiV dhe ROR. Aplikacionet mund të dorëzohen edhe fizikisht përmes postës në adresën “OJQ Syri i Vizionit”, rr. Isa Demaj, nr. 14, 30 000-Pejë.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është me datë: 14 Mars 2023, ora 16:00.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!